

Ky dokument nuk është prova. Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

ARTIKULLI

TITULLI	Çim Peka Live - 'Rama e krijoi më herët alibinë për arrestimin e Vlora Hysenit', Bushati: Është në ngërç, mund të ketë dosje...
ADRESA	https://www.syri.net/politike/918507/rama-e-krijoi-me-heret-alibine-per-arrestimin-e-vlora-hysenit-bushati-eshte-ne-ngerc-mund-te-kete-dosje/
BURIMI	syri.net
GJENDJA	online

KOHA


KAPUR NGA NE	23 shtator 2026, 18:43:20 UTC <i>Dritarja jonë e pasigurisë: ± 300 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.</i>
DEKLARUAR NGA PORTALI	22 shtator 2026, 19:15:41 UTC <i>Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.</i>

HASH-ET · SHA-256

PËRMBAJTJA	4ae1e6711052e76f7192a331aff447b5d1f944a6bb8ee366df010bb30748ff22
TEKSTI	1f7837a2ba3a6ab709d2366d508afd39e0759c8178c73900d335afa355664901
PAMJA	ccde6baac91add035cf843909277a710e9149f072bcef350a554a90f23db623a

ZINXHIRI I PROVËS

KJO HYRJE	76837d9a6fe73edf1b12deb091ac59e92ea8b51417b32d40406f0b314aa7f696
E MËPARSHMJA	—
RRËNJA MERKLE	0a84bfe3f4510e3e6e98dba2fbf96359a912d940176f0d9eba05fd7152dcd223
ANKORIMI	submitted — dërguar, ende pa bllok <i>Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.</i>



SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.



Faqja tregon njërin nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahazo hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

<https://scan.stamles.eu/verify/76837d9a6fe73edf1b12deb091ac59e92ea8b51417b32d40406f0b314aa7f696>

PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px

**ENVER BYTYÇI**Vendimi i Hagës dhe raporti
ynë me të vërtetën!**ENVER ROBELLI**Qëndrimi i Zagrebit dhe
heshija e Tiranës**LAJMI I FUNDIT****Arrestohet në Rusi grosisti i kokainës Shpëtim Aliu****më të lexuarat****VIDEO-**'Janë 3 orë përgjime'/ Ahmetaj:
Javën tjetër do publikojmë edhe dy
pasazhe të tjera. Monaco ...Ura shembet 1 javë pas inaugurimit/
Vata: 40 mln lekë nga paratë e qytetarëve
të hedhura në lumëProtesta e 53-të në Divjakë/ Banorët
vijnë qëndresën kundër propozimit të
PS për bashkimin me LushnjënProtesta e 114/ Mbyllen fjalimet para
Kryeministritë, qytetarët nisin
marshimin: Rama jepe dorëheqjen'Rusia synon përçarjen'/ Burimi: Sulmet
hibride për të sjellë në pushtet forcat që
nuk ndihmojnë Ukrainën**VIDEO-**'Hajde të tregoj unë ty'/
Përplasja me Ramën në avion, i ri: Më**'Rama e krijoi më herët alibinë për
arrestimin e Vlorë Hysenit', Bushati:
Është në ngërç, mund të ketë dosje...**

21:15, 22/09/2026

ZMADHO TEKSTIN**Analisti Andi Bushati shprehet se kryeministri Edi Rama ishte në dijeni në
arrestimin të drejtoreshës së SHISH, Vlorë Hyseni, ndaj për këtë arsye ka
krijuar alibinë e tij.**

I ftuar në 'Çim Peka Live' në Syri Tv, Bushati tha se ishte e pabesueshme që një
institucion si SHISH të arrinte deri këtu, sa drejtoresha e tij të nxirrte sekretin dhe
të mbronte banditët.

Sipas Bushatit, reagimi i Ramës për këtë çështje nga Asambleja e Përgjithshme e
Komabeve të Bashkuara ku merrte pjesë, ishte ajo e një gjuhe të dyfishtë, pasi
këkron edhe të mos e hedhë poshtë Vlorë Hysenin, për shkak të dosjeve që kjo e
fundit mund të ketë në dorë dhe që kryeministrit mund t'i hapen probleme të
mëdha.



Përflitej shumë po askush nuk e priste që të arrihej deri këtu. Pra,
dihej që përflitej, dihejshin lidhjet, dihejshin të gjitha. Edhe Proda dihej,
edhe Vlorë Hyseni. Problemi është që ne akoma tani kemi shumë pak
informacion. Është nga herët e para që SPAK-u vepron dhe nuk
rrjedhin informacione për gazetarët e SPAK-ut e të tjera e të tjera. Pra
dimë që kjo zonja ka nxjerrë sekretin shtetëror dhe ka mbrojtur këta
banditët. Dhe këtu pastaj, kaq dihet si fakte, këtu jemi në rrafshin e
hipotezave dhe hipotezat që ngrihen tani.

Pra, ti ngrite dy pyetje. E para a e dinte, a ishte i përfshirë Edi Rama,
dhe e dyta a mund të bëhet kjo pa aleatët tanë, pa amerikanët
kryesisht. E para, nga mënyra si reagoi sot Edi Rama, me vonesë, me
një gjuhë të dyfishtë... domethënë, një njeri që akuzohet, minimumi
akuzohet, se ka nxjerrë sekretet shtetërore dhe ka bashkëpunuar me
kriminelë, mundet kryeministri i një vendi ta falënderojë? E pastaj pasi
ta falënderojë për arritjet e mëdha që ka pasur në SHISH, edhe të

thotë që ajo ka fajet e saj personale dhe mëkatet e asaj nuk e dëmtojnë qeverinë.

Pra çfarë tregonte kjo gjuhë e dyfishtë? Kjo gjuhë e dyfishtë tregonte që Rama ishte në ngërç. Ishte në një ngërç me atë që edhe nuk do të njësohet me bandën e Ergys Agasit, se po ta mbrojtë publikisht, njësohet, por dhe nuk do ta hedhi poshtë se di që pozicioni i asaj zonjës ka ca dosje që mund t'i prishin punë. Prandaj bën deklaratatë tilla që s'janë as mish as peshk. Dhe prandaj detyrohet, gënjej, që unë e mora vesh më vonë se jam në New York.

Ndërkohë, që po të hapësh intervistën e Ramës tek kolegja jonë Rudina Xhunga, ai gati ka bërë alibinë që unë s'kam pasur lidhje me Vlora Hysenin sepse thotë, të gjithë bota e di që unë raportet e SHIK-ut, e tha në SHIK unë i jap besim, i lexon vetëm shefja ime e kabinetit, unë s'di gjë. Pra, ai e ka ditur shumë mirë ç'do ndodhi më pas, por bëri të paditurin. Dhe kjo tregon, kjo tregon që Rama ka një ngërç me këtë punë.

Rama padyshim ka qenë në dijeni, ka bërë dy javë përpara alibinë. Nuk mundet, nuk mundet, jo ky shteti jonë që është shtet banditesk, po as në shtete serioze, të arrestohet shefja e shërbimit inteligjent, kryeministri detyrimisht lajmërohet. Nuk ndodh në asnjë vend. Jo më këtu që këta e kanë të gjithë shtetin të vetin. Pra, padyshim Rama e ka ditur, po këtë e provon dhe fakti që Rama dy javë, në gjashtë shtator, ka bërë alibinë, unë s'e di çfarë bënte, unë i kam dhënë besim të plotë, vetëm shefja ime e kabinetit e kontrollonte.

E dyta, dhe kjo e shton pastaj misterin, është pyetja jote e dytë. A bëhet kjo pa amerikanët? Ne mbajmë mend, kur Sali Berisha donte të shkarkonte shefin e SHIK-ut, u bë nami. U bë nami si mund ta shkarkosh ti që e kishte kompetencë të vetën, pa pyetur aleatët. Këtu nuk bëhet më fjalë për shkarkim, po këtu bëhet fjalë edhe për arrestim, dhe askush nuk foli. Pra, a kemi diçka aq të rëndë sa edhe partnerët, se SHIK-u dihet që kontrollohet nga amerikanët, e kanë lëshuar? Dhe a shkon kjo përtej Vlora Hysenit? Këto janë pyetjet që në mungesën e fakteve bazë, po me logjikë dhe duke njohur kuadrin e madh, janë pyetjet më themelore sot, mendoj unë.

© SYRI.net

Lexo edhe:



'Për 10 ditë Rama do ikë, fjalë burrash'// Thirrja e nënës për të rinjtë: Mos rri në kafe, ejani këtu




Po tani, kush do ta shpëtojë Shqipërinë nga turpërimi?!



Vlora Hyseni e arrestuar/ Demiraj: Duhej mbledhur Këshilli i Sigurisë Kombëtare! Në SHBA janë të skandalizuar


Kapri për qatë unë me unë te zotun



Akuzat ndaj shefes së SHISH vënë në pikëpyetje sigurinë kombëtare të Shqipërisë



'S'ka normalitet për situatën ku ndodhemi', Këlliçi: Të gjithë e kanë pranuar skandalin e Roni Yeffet, Rama jo!



'Rama, një bandit që vjedh i pashqetësuar', Blushi: 'KAYO' e rivërtetoi se shteti është mafie sot!

TË NGJASHME



Berisha: Vetëm demokratët mund t'i japin goditjen përfundimtare këtij regjimi! Pa largimin e Ramës, Shqipëria vetëm do rrokulliset



'Rama jep dorëheqjen'! – Nis marshimi i qytetarëve nga sheshi 'Skënderbej' drejt Kryeministrisë



Berisha: Mbështetja e protestës qytetare, detyrë madhore e PD! Duhet të bëjmë çdo gjë për ripërtëritjen e partisë



VIDEO/ Berisha: Bojkoti do ishte avantazh për Ramën, ne do i japim atij përgjigjet më të forta në parlament



'Rama jep dorëheqjen'! - Shqiptarët në revoltë kundër qeverisë: Shteti ka rënë



Rama injoron konsultimet publike, fut në shqyrtim Reformën Territoriale



VIDEO/ Berisha: Vlora Hyseni e kishte pajisur Agasin me mjetet më të sofistikuar të përgjimit dhe survejimit



SYRI.net është agjencia më e madhe e lajmeve në Shqipëri, që brenda një kohe të shkurtër është kthyer në lider të informacionit. Në SYRI.net do të gjeni opinionistë më me emër në vendin tonë, investigime dhe lajme që nuk do ti gjeni diku tjetër. Lajmet në SYRI.net janë prodhim i SYRI.net dhe nuk lejohet marrja e tyre pa një komunikim të mëparshëm me redaksinë. Ju ftojmë të klikoni dhe të na shkruani sa herë që ju mendeni se duhet. Stafi i SYRI.net

Për informacione info@syri.net, për reklama marketing@syri.net

Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.